

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ILED SERVICE" Sh. P. K.**



Në Tiranë më datë 26 Shkurt 2018, në mbështetje të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", formohet Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "**ILED SERVICE**" sh.p.k me ortak të vetëm themelues:

**Z. LUIGI IPPOLITI** i biri i Marco Ippoliti dhe Cannella Pulcini i lindur në San Benedeto Del Tronto më 24.09.1942 banues në San Benedeto del Tronto, Itali, Via Tagliamento 23, shtetas italian, i pajisur me Karte Identiteti Italiane 3026828AA.

**SELIA**

**"ILED SERVICE" Sh. P. K** e ka selinë e saj në: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 2, Rr. "George W. Bush", Pallati "ALBSIG", kat 2, zyra 19. Shoqeria mund te hape filiale edhe ne rrethe të tjera brenda dhe jashte vendit.

**KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtariseëekonomike të Shoqërise tregtare është pa afat.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

*Shoqëria ka për objekt zhvillimin e këtyre aktivitetave me objekt si vijon:*

- Konsulencë, marketing, shërbime për kompanitë ne fushen financiare, juridike dhe inxhinierike.
- Aktivitet ne fushen imobiliare, shitje-blerje te apartamenteve, ndertesave industriale dhe tregtare.

*Ky aktivitet do të zhvillohet në fushën internacionale dhe në atë nacionale.*

Si objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

**KAPITALI I SHOQERISË**

Kapitali themeltar filletar i Shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) kontribut i Ortakut të vetëm themelues në përpjeste të shprehura ne Statut.

## **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të Shoqerisë janë Asambleja e Ortakëve dhe Administrator të jetë **Z.LUIGI IPPOLITI**.



### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimet neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci, pasi te zbriten shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore, fondit rezerve dhe te tjera te percaktuara me ligj ose ne Statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve ndahen perpjestimisht sipas kontributit perkates te Ortakeve.

### **MOSMARRËVESHJET**

Mosmarreveshjet eventuale që mund të lindin midis Ortakëve gjatë zbatimit te ketij Akti Themelimi, ose midis Shoqërise dhe Ortakëve gjate aktivitetit te Shoqerise, duhet te zgjidhen me ane te biscdimeve. Në rast të kundërt palët i drejtohen Gjykatës kompetente.

### **TË TJERA**

Dispozita më të hollësishme për funksionimin e Shoqerise, përshkruhen në Statutin e saj që është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

Ky Akt Themelimi është hartuar në pesë kopje të barazvlereshme dhe pasi u lexua u firmos rregullisht nga :

ORTAKU I VETËM

"ILED SERVICE" sh.p.k

**Z. LUIGI IPPOLITI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr—380—REP  
Nr—\_\_\_\_\_—KOL

### VËRTETIM NOTERIAL

Sot më datë 26 Shkurt 2018 (*dymjë e tetëmbëdhjetë*), ditën e hënë, para meje Noterit **SOKOL Sh. MALAJ**, Noter në Dhomën e Noterisë Tiranë, me Seli në Rr. "L.Gurakuqi", Pallati "ALBSIG" u paraqit personalisht:—

**Z. LUIGI IPPOLITI** i biri i Marco Ippoliti dhe Cannella Pulcini i lindur në San Benedeto Del Tronto më 24.09.1942 banues në San Benedeto del Tronto, Itali, Via Tagliamento 23, shtetas italian, i pajisur me Karte Identiteti Italiane 3026828AA, me cilësinë e Ortakut të Vetëm/ Administratorit të shoqërisë "**ILED SERVICE**" sh.p.k.—

I lartpërmenduri është madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili deklaroi se nuk e kuption gjuhën shqipe dhe asistohet prej meje Noterit në gjuhën italiane, e pasi u sqarua për pasojat Juridike që sjell ky, -Akt Noterial i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**ILED SERVICE**" sh.p.k - deklaroi se sa më sipër është një akt – **Akt Themelimi I Shoqërisë** - i hartuar me vullnetin e tij të lirë e të plotë jashtë kësaj zyre.—

Unë Noteri pasi konstatova se ai akt nuk vjen në kundërshtim me ligjin dhe interesat e kërkuesit u nënshkrua në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.—

Për të vërtetuar sa më sipër u hartua ky akt notarial i cili si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të porositësit u nënshkrua në praninë time, sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—*Tiranë, më 26.02.2018*—

**NOTER**  
**SOKOL SH. MALAJ**  
RR.Luis Gurakuqi P.2  
TIRANE / ALBANIA  
Tel. 00355 (4) 2279832  
Col. 00355 65 47 65554

**TAKSA E PULLES  
U PAGUA**

